



Në bazë të nenit 7, alineja 9 të Ligjit për themelimin të Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Maqedonisë nr. 72/07 dhe 5/09), Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural shpall

THIRRJE PUBLIKE nr. 01/2014

për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzim të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare në peshkari dhe akuakulturë për vitin 2014

I. LËNDA E SHPALLJES

Lënda e kësaj shpallje është ndarja e përkrahjes financiare për nënpikat nga masat në vijim:

Masa 2	Përkrahja financiare në akuakulturë	Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme
Nënpika 2.2	Përkrahja financiare për material peshkim nga prodhimet vendore	- 12.562.419,00 denarë - Deri më 600,00 denarë sipas maticës ose 40% nga vlera e të vegjëlve të furnizuar
Nënpika 2.3	Përkrahje financiare për peshkun e prodhuar dhe të shitur në treg	- 1.500.000,00 denarë - 10,00 ose 20,00 denarë/kg

II. TË DREJTË PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE

Të drejtë për shfrytëzimin e mjeteve sipas nënpikave kanë:

Subjektet	Nënpikat
<ul style="list-style-type: none"> Subjektet të cilat posedojnë leje për prodhimin e materialit për peshkim nga baseni i peshqve i dedikuar për shitje dhe që nuk kanë importuar material për peshkim dhe peshq të gjallë gjatë periudhës dhjetor 2013 – dhjetor 2014. Për të vegjlit e furnizuar subjektet të cilat janë të regjistruara për veprimtari akuakulturë dhe janë të regjistruar në regjistrin të ruajtësve të peshqve që është në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave dhe kanë blerë të vegjlit nga subjektet që posedojnë leje për prodhim të materialit për peshkim nga basene të dedikuara për shitje Subjektet të cilat posedojnë leje për prodhimin e materialit për peshkim nga basene të dedikuara për shitje për ruajtje vetanake të basenit për peshq. 	2.2
Subjektet të cilat janë të regjistruara për veprimtari akuakulturë dhe janë të regjistruara në regjistrin të ruajtësve të peshqve që gjendet në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave nuk kanë importuar material për ruajtje të peshqve dhe peshk të gjallë në periudhën prej 01 dhjetor 2013 – 31 nëntor 2014.	2.3

III. SHUMA E PËRKRAHJES FINANCIARE

Mjetet nga nënpika 2.2 për materialin për peshkim nga prodhimi vendor janë për qëllim të ruajtjes të maticave dhe furnizim të materialit për peshkim nga llojet e troftës së Ohrit, të lumit dhe ylber, më saktësisht, të artë, krap, amur, tolstolobik dhe som,

Mjetet nga nënpika 2.3 janë të dedikuara për peshk të prodhuar në vitin 2013 dhe të shitura më së voni deri më 31 nëntor të vitit 2014.

Për nënpikën 2.2 përkrahja financiare paguhet në shumë prej 600,00 denarë për maticë për jo më shumë se 700 numra të selektuar dhe të shënuara për matica të pjekura, për lloje të veçanta të peshqve për llojet e troftës së Ohrit, të lumit dhe ylberor dhe më saktësisht ajo e artë, për jo më shumë se 300 numra nga lloji i krapit dhe jo më shumë se 50 numra për llojet amur, som dhe tolstolobik. Për të vegjël të blerë përkrahja financiare paguhet sipas parimit 40% nga çmimi mesatar i tregut të të vegjëlve të furnizuar të përcaktuar nga ana e Ministrisë.

Mjetet nga nënpika 2.3 paguhet në mënyrë të shkallëzuar edhe atë:

- për peshk të prodhuar në basen të peshqve me kapacitet të projektuar deri më 25 000 kilogram - 100 % prej 20,00 denarë,

- për peshk të prodhuar në basen të peshqve me kapacitet të projektuar prej 25 000 deri më 50 000 kilogram - 75 % prej 20,00 denarë,

- për peshk të prodhuar në basen të peshqve me kapacitet të projektuar prej 50 000 deri më 100 000 kilogram - 50 % prej 20,00 denarë dhe

- për peshk të prodhuar në basen të peshqve me kapacitet të projektuar me mbi 100 000 kilogram prodhim 25 % prej 20,00 denarë.

Shuma e vlerës të mbështetjes për kilogram peshk i prodhuar dhe i shitur nga llojet autoktone të peshqve – trofta e lumit dhe trofta e Ohrit do të jetë 20,00 denarë për kilogram, ndërsa për llojet troftë ylberore, më saktësisht të artë, krap, amur, som dhe tolstolobik 10,00 denarë për kilogram.

IV. KUSHTET PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI I CILI DUHET TË DORËZOHET

Kërkesat për nënpikën e veçantë dorëzohen në origjinal.

Kushtet të cilat dihet ti plotësojnë kërkesit të mjeteve janë përcaktuar në Programin për përkrahje financiare në peshkari dhe akuakulturë për vitin 2014 ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 8/2014 dhe 129/2014).

Nëse në Agjenci dorëzohen më shumë kërkesa sesa ka mjete në disponim në pajtim me Programin për përkrahje financiare në peshkari dhe akuakulturë për vitin 2014, Agjencia do tu japë përparësi atyre kërkesave që kanë dorëzuar kërkesën e tyre më herët se të tjerët.

Subjektet të cilat dorëzojnë kërkesë për shfrytëzimin e mjeteve, mund të shfrytëzojnë mjetet vetëm nga njëra nënpikë, gjegjësisht një në bazë të nënpikës 2.2. ose në bazë të nënpikës 2.3.

V. MARRJA E FORMULAREVE DHE UDHËZIMEVE

Formularët "Kërkesa për shfrytëzim të mjeteve" dhe "Kërkesë për pagesë" së bashku me listën e dokumenteve të nevojshme dhe Udhëzimin e shfrytëzuesve mund të merren në ueb faqen e Agjencisë www.ipardpa.gov.mk.

Formularët e lartpërmendur mund të merren dhe drejtpërdrejtë në Agjenci çdo ditë pune prej ora 8:30 deri në ora 16:30 në adresën:

**Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural,
Bul. "3-ta Makedonska Brigada" nr. 20
(ndërtesa e Makedonija Tabak blloku C)
1000 Shkup**

MËNYRA E DORËZIMIT TË DOKUMENTEVE

Kërkesat e plotësuara për shfrytëzim të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare në peshkari dhe akuakulturë për vitin 2014 së bashku me tërë dokumentacionin e duhur dorëzohen në gjuhën maqedonase në zarf të mbyllur me shënim në këndin e majtë lart të anës së përparme të zarfit "MOS HAP" për Thirrjen publike nr. 01/2014 dhe shënimin e shifrës së nënpikës për të cilën dorëzohet kërkesa. Kërkesa mund të dorëzohet përmes postës ose personalisht në arkivin e Agjencisë.

Nëse zarfi nuk është shënuar siç duhet, Agjencia nuk merr përgjegjësi për arrijten jo në kohë ose të pakompletuar, po hapjen e parakohshme të kërkesës.

Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve dhe kërkesave për pagim është 10.11.2014. Kërkesat e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk do të merren në shqyrtim.

Informata më të detajuara në kontakt telefonin (02) 3097-460 ose në kontakt e-mail adresë: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk dhe në ueb faqen: www.ipardpa.gov.mk ose www.pa.gov.mk.

Kontakt:

Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, Sektori për miratimin e projekteve dhe Sektori për miratimin e pagesës.

Telefoni: **02 3097 - 460**, çdo ditë pune prej 08:30 deri në ora 16:30.

E-mail: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk

